VENDIM
Nr.801, datë 20.12.2005

PËR HAPJEN E UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" NË DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapja e Universitetit "Aleksandër Moisiu", në Durrës, në vitin akademik 2006-2007.
2. Universiteti "Aleksandër Moisiu", me seli qendrore në qytetin e Durrësit, do të përbëhet nga:
a) Fakulteti i Edukimit;
b) Fakulteti i Ekonomisë dhe i Administrimit;
c) Shkolla e lartë jouniversitare.
3. Fakulteti i Edukimit do të japë diplomë universitare në degët:
a) Cikli i ulët (tre vite akademike);
b) Gjuhë angleze (tre vite akademike);
c) Kualifikime pasuniversitare në fushën e mësuesisë dhe të menaxhimit të arsimit.
4. Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit do të japë diplomë universitare në degët:
a) Shkenca të administrimit (tre vite akademike);
b) Menaxhim turizëm (tre vite akademike).
5. Shkolla e lartë jouniversitare do të japë diplomë të nivelit jouniversitar. Përcaktimi i diplomave bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dy muaj para fillimit të vitit akademik.
6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha